



## **PROGRAMI "QYTETI I ARTEVE" i Akademisë së Arteve Tiranë**

Akademia e Arteve, në kuadrin e pasurimit të jetës artistike në vend, rritjen e konkurrencës në tregun artistik si dhe për rritjen e mundësisë së personelit akademik dhe studentor që të prezantojnë arritjet më të mira krijuese dhe interpretuese të këtij institucioni, shpall konkursin për projekte artistike pranë Akademisë së Arteve.

### **Objektivat**

1. Të mbështesë krijimtarinë në të gjitha fushat e artit që edukohen dhe zhvillohen brenda AA-së.
2. Të ngrejë cilësinë artistike të interpretimit, ekzekutimit dhe krijimtarisë.
3. Të zhvillojë marketingun në ambientet e Akademisë së Arteve.
4. Të rrisë vizibilitetin e AA-së nëpërmjet publicitetit të ngjarjeve që financon Programi.
5. Të krijojë ngjarje me qendrueshmëri dhe vazhdimësi p.sh. bienale e artistëve të rinj, festivale muzikore, të filmit të regjizorëve të rinj, ose master-class-e të cilat kurorëzohen me një ngjarje, ose event artistik etj., pra veprimtari që të shndërrohen dhe të kenë impakt në të ardhmen në veprimtari kombëtare ose ndërkombëtare.

### **Vizioni i programit dhe prioritetet:**

Për realizimin me sukses të këtij Programi duhet të shihen si prioritet dhe të arrihen këto objektiva:

- 1 Shpërfaqja e vlerave dhe potencialit krijues të pedagogëve e studentëve të Akademisë së Arteve;
- 2 Aktivizimi i studentëve të sapo diplomuar dhe realizimi i projekteve të përbashkëta student-pedagogë. Praktikë e cila do të përgatisë dhe opinione rreth punësimit të të rinjve pranë AA-së
- 3 Visibilitet më i madh i programit të AA-së për të krijuar një vazhdimësi për 2011 bazuar në cilësinë artistike dhe marketingun;
- 4 Zhvillimi i jetës artistike të AA-së të shikohet dhe ndjehet si një kontribut në jetën artistike të qytetit të Tiranës;



- 5 Krijimi i një bërthame menaxhimi të jetës artistike pranë AA-së e cila të zhvillojë dhe marketingun e ngjarjeve të AA-së;
- 6 Zhvillimi i bashkëpunimit me partnerë të huaj për rritjen e cilësisë duke u koordinuar dhe me fondet dhe projektet europiane IPA etj;

### **Organizimi dhe kriteret**

Për pranimin, koordinimin dhe monitorimin e projekteve artistike, krijohet Zyra Koordinuese e Eventeve **ZKE**.

Për vlerësimin artistik, dhe rradhitjen e projekteve fituese sipas kriterëve fituese, krijohet Bordi i Projekteve Artistike **BPA**.

Bordi mbledhet jo më pak se dy herë në vit dhe thirret nga ZKE në varësi të afateve të shpallura për aplikim nga kjo zyrë.

### **Kriteret e përshtatshmërisë**

Projektet nuk duhet të jenë:

- Botime shkencore dhe tekste mësimore;
- Bursa studimi për brenda dhe jasht shtetit;
- Kosto ndërtimi dhe mirëmbajtje infrastrukture;
- Aktivitete ekskluzivisht komerciale;
- Shpenzime për organizimin e procesit mësimor;
- Shpenzime për provime dhe mbrojtje diplome të individëve;

Gjithashtu projektet duhet:

- Të kenë si synim kryesor një nga objektivat dhe prioritetet e përcaktuara;
- Të realizohen në publik dhe përballë audiencës së gjërë;
- Aplikuesi duhet të kontribuojë në masën 20% (në cash ose kontribute të tjera);
- Të respektojë normat ligjore dhe financiare në realizimin e projektit;
- I njëjti aplikant nuk mund të përfitojë më shumë se një projekt në vit dhe më shumë se dy herë rresht;



- Aplikanti nuk mund të jetë anëtar i Bordit të Projekteve Artistike dhe | ose pjesëtar i ZKE-së;
- Të drejtën e aplikimit e kanë vetëm personeli akademik me kohë të plotë dhe studentët me kohë të plotë për të cilët (studentët) projekti duhet të përfundojë ndërkohë që janë në marrëdhënie me AA;
- Aplikanti nuk mund të aplikojë në emër të institucioneve shtetërore (përveç AA-së) si dhe institucioneve private konkurruese që e shtrijnë aktivitetin e tyre në të njëjtën fushë me Akademinë e Arteve;
- Aplikanti duket të pranojë kushtet e grantit;
- Financimi i projektit nuk mund të transferohet në vitin pasardhës;
- Formulari i Aplikimit duhet të jetë i plotësuar në mënyrë korrekte dhe pa korrigjime sipas rubrikave të përcaktuara duke shprehur qartë qëllimin dhe afatet e projektit. Studentët duhet të shoqërojnë Formularin edhe me dy rekomandime nga personeli akademik me kohë të plotë i Akademisë së Arteve;
- Aplikantët duhet të dorëzojnë Formularët e Aplikimit të plotësuar në tre kopje origjinale dhe një kopje në formë elektronike pranë ZKE-së, pas protokollimit në Zyrën e Protokollit të Akademisë së Arteve. Formulari i Aplikimit mund të gjendet dhe të shkarkohet nga website-i i Akademisë së Arteve.
- Aplikantët kanë detyrimin të dorëzojnë një raport të detajuar në përfundim të projektit, shoqëruar me materiale dhe dokumentacionin përkatës siç janë postera, fletë-palosje, fotografi nga aktiviteti ose cd dhe dvd, katalogë etj. si dhe kritika dhe kronika në mass-media nëse ka patur.

#### **Kritere të tjera**

1. Artistët e ftuar nga programe të tjera të Qeverisë si "Brain gain" mund të përfshihen në krijimtari ose interpretim në ngjarje të ndryshme të këtij programi;
2. Projekt-propozimet mund të kenë bashkëpunëtorë artistë të huaj me vlera, por të financuar nga institucionet ndërkombëtare prezente ose jo në Shqipëri;
3. Aplikuesit duhet të gjejnë vetë një mbështetje financiare jo më pak se 20% të buxhetit të paraqitur nga sponsorë ose nga të ardhura të tjera;
4. Programi duhet të ketë një limit financimi deri në 1.000.000 lekë për çdo projekt propozim;



5. Të përfshijë master-class-e dhe workshop-e kur ka bashkëpunime me artistë të huaj;
6. Amfiteatri dhe ambiente të tjera të AA-së të gjallërohen me aktivitete duke i dhënë një visibilitet më të madh në jetën artistike të Tiranës;
7. Veprimtaritë artistike që do të realizohen në A.A. mund të dalin dhe përtej mureve të saj dhe të zhvillohen në qendra historike ose të rëndësishme të Tiranës ose qytete të tjera;

**Zyra Kordinuese e Eventeve pranon Aplikimet dhe përgjigjet direkt për përmbushjen e kriterëve të përshtatshmërisë, objektivave dhe prioriteteve duke i paraqitur BPA-së projektet që plotësojnë kushtet, shoqëruar me komentimin përkatës.**

**Vetëm projektet që përmbushin kriteret e mësipërme do të paraqiten në Bordin e Projekteve Artistike. Në këtë pikë, aplikimet do të diskutohen dhe do të rradhiten fituese ose jo, nga BPA sipas kriterëve përzgjedhëse të mëposhtme:**

### **Kriteret Përzgjedhëse**

**Cilësia Artistike:** Me qëllim të vlerësimit, cilësia artistike do të konsiderohet në termat e mëposhtëm:

- Cilësia dhe kapaciteti profesional i aplikuesit, pjesëmarrësve dhe partnerëve të tjerë;
- Origjinaliteti;
- Shtrirja;
- Rezonanca në publik, opinionin artistik dhe joartistik si dhe në median e shkruar dhe audiovizive;

**Novacioni:** Projektet duhet të demostrojnë Novacion në idetë dhe | ose në realizimin e tyre.

**Vizibiliteti:** Elementët më të rëndësishëm në këtë aspekt janë:

- rritja e prezencës së AA në jetën kulturore të Kryeqytetit dhe më gjerë në mënyrë që të rritet interesi për bashkëpunim me Institucionin tonë;
- bërja më prezente e Akademisë përballë tregut të arsimit në fushën e Artit nëpërmjet aktiviteteve cilësore duke rritur në këtë mënyrë dëshirën për të studiuar artet;



- publiciteti që realizohet me materialet propaganduese të këtyre aktiviteteve (postera, fletë-palosje etj.);
- prezenca aktive në massmedia nëpërmjet konferencave për shtyp, kronikave etj;
- prodhimi i CD, DVD, Partiturave, Katalogëve etj (kopje të të cilave duhet dorëzohen pranë bibliotekës dhe fonotekës së AA-së);

**Promovimi:** Për plotësimin dhe vlerësimin e këtij kriteri është i rëndësishëm:

- promovimi i vlerave më të spikatura të artit bashkëkohor dhe atij të traditës që zhvillohet nga stafi pedagogjik dhe studentët e Akademisë;
- Promovimi kapaciteteve profesionale të personelit akademik dhe studentëve krijues dhe interpretues jo vetëm brenda por edhe jasht vendit;

**ZKE dhe BPA kanë të drejtë të kthejnë mbrapsht për plotësime dhe/ose të shpallin jofitues projektet kur ato nuk plotësojnë Kriteret e shpallura.**

ZKE dhe BPA kanë detyrimin të ndjekin dhe monitorojnë realizimin

Aplikantët fitues kanë të drejtë financimi deri në 60% para fillimit të projektit. 40 % i mbetur paguhet gjatë ose në përfundim të projektit.

**ZKE monitoron dhe vlerëson nëse projekti gjatë aplikimit të tij i përmbahet qëllimeve dhe shpenzimeve të shpallura. Nëse projekti i shkel ato, ZKE-së i lind e drejta të ndërpresë financimin e projektit dhe të kërkojë rimbursimin e fondeve të lëvruara deri në atë moment.**

**Prof. Petrit MALAJ**

---

**REKTOR  
AKADEMIA E ARTEVE**